REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 872/20
Datë/Datum. 30.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

KOMUNA E VUSHTRRISË

Për Aktivitetin e Prokurimit: **644-20-4423-5-1-1**

Sa i përket tenderit për "**Asfalltimi i rrugëve në lokale në fshatra sipas lot1 dhe lot 2 (LOT 2)**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"Rahovica Company" SHPK - Ferizaj

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Ferizaj

(Adresa) *Ferizaj* *70 000*

(Vendi) *(Kodi postar)*

049/120-969

(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Fehmi Krasniqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

f.rahovica@hotmail.com

(Adresa elektronike)

29.10.2020

RAHOVICA COMERCE SH.P.K.
Tel. 0290/ 320 012
FERIZAJ

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.
Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Shpallja e procedurës ne e-prokurim *(13.08.2020)*
Dorëzimi i tenderit: 17.09.2020 ora 14:00
Hapja e ofertës *(17.09.2020 ora 14:00)*
Njoftimi Leter standarde:13.10.2020
Njoftimi mbi vendimin e AK-se (rivlerësimi) 13.10.2020
Kerkesa per qasje: 13.10.2020
Qasja ne dokumente 15.10.2020
Kerkesa per rishqyrtim: 19.10.2020
Kriteri i dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me çmim me te lire

4. **Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	☐			Jo	√

Kemi pranuar procesverbalin e hapjes

5. **Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	√			Jo	☐

Vendimi i AK – Refuzim i kërkesës për rishqyrtim sipas nenit 108/A

6. **Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura nga AK: **Sipas dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik, nr.04/L-042**
Neni 1 – Qellimi i ligjit; **Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti;** **Neni 7 – Barazia ne trajtim/jo-diskriminimi** **Neni 59 – Krahasimi, vlerësimi dhe ekzaminimi i tenderëve;** **Neni 61 – Çmime jo normalisht te ulëta** **Neni 69 – Aftesia teknike dhe/ose profesionale;** **Neni 39 i RrUOPP-së** **Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve**

** *Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK nuk e ka trajtuar fare kerkesen tone per rishqyrtim, dhe ka bere shkelje flagrante qe do tua sqarojme si me poshte.

Autoriteti Kontraktues me Letrën standarde neve si OE. "Rahovica Company" SHPK na ka klasifikuar si OE te eliminuar, me arsyetimin se:

Tenderi juaj eshte vleresuar me kujdes :

Deshmite sic eshte pershkruar ne Seksionin II.Fleta e te dhenave te tenderit (FDT) te dosjes se tenderit , Kerkesat mbi kapacitetin teknik dhe ose profesional neni 9.1 lidhur me nenin 9.2, pika 1 "Projekte te perfunduara te puneve te ngajshme (ndertim, rehabilitim, rekonstruim rrugeve) ne tre vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate , jo me pak se per LOT 1 1,299,064.91 € dhe per LOT 2- 1,820,261.43 € Ne rast grupit te oiperatorit ekonomik lideri i grupit duhet te kete kontrata te realizuara gjate tre viteve te fundit deri me dt.e publikimit te njoftimit per kontrate, jo me pak se 60% te vleres se saktesuar si me larte", si dhe pika 2 nenpika (b). :Nje inxhinier i diplomuar i ndertimtarise apo master, 2 vite pervoje pune pas diplomimit (drejtimi konstruktiv apo arqitekture), i emeruar me vendim si udheheqes i punishtes ne projektet e ndertimit, rehabilitimit apo rikonstruimit te rrugeve. Te kete min. Nje (1) projekt te realizuar ne lemin e kerkuar "tregojne arsyeshem se ju nuk jeni i permbushni kerkesat minimale te kapacitetit teknik dhe/ose financiar te saktesuara ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin per kontrate sikurse u saktesua me larte, qe nenkupton se:

Ne lotin 1: Asfaltimi i rrugeve lokale ne 13 fshatra, Ju nuk permbushni kerkesen e A.K. qe, gjate tre viteve te fundit deri me daten e publikimit te Njoftimit per Kontrate, lideri i Grupit te kete perfunduar pune te ngjashme (ndertim, rehabilitim, rikonstruim te rrugeve) ne vlere prej 779,438,94 €, pasi qe, bazuar ne vleren e referencave te dorezuara Ju gjate tre viteve te fundit, nga data e publikimit te Njoftimit per Kontrate, keni realizuar perfunduar projekte ne vlere prej 759,383.41 Euro, po ashtu

Ne Lotin 2 : Asfaltimi i rrugeve lokale ne 14 fshatra, Ju nuk permbushni kerkesen e A.K. qe, gjate tre viteve te fundit deri me daten e publikimit te Njoftimit per Kontrate, lideri i Grupit te kete perfunduar pune te ngjashme (ndertim, rehabilitim, rikonstruim te rrugeve) ne vlere prej 1.092.156,86€ pasi qe, bazuar ne vleren e referencave te dorezuara Ju gjate tre viteve te fundit, nga data e publikimit te Njoftimit per Kontrate, keni realizuar perfunduar projekte ne vlere prej 759.383,41€, , qe nenkupton se nuk permbushni kerkesen e A.K. ne Lotin 1 dhe Lotin 2, sikurse Eshte saktesuar ne Seksionin II. Fleta e Te Dhenave te Tenderit (FTD) te Dosjes se Tenderit, Kerkesat mbi kapacitetin teknik dhe / ose profesional, neni 9.1 lidhur me 9.2, pika 1.

Ju nuk permbushni kerkesen e AK sikurse eshte saktesuar ne Seksionin 2 Fleta e te dhenave te tenderit te dosjes se tenderit, Kerkesat mbi kapacitetin teknik dhe /ose profesional, neni 9.1 lidhur me 9.2, pika 2 nenpika **b) Një (1) Inxhinier i diplomuar i** *Ndërtimtarisë apo master, 2 vite përvojë pune pas diplominit (drejtimi konstruktiv apo arqitektur), i emëruar me vendim si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit apo rikonstruktimit të rrugëve. Të ketë minimum një (1) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar", pasi qe pas kerkeses me shkrim nga AK inxhinieri i prezantuar nga ju z.Gazemend Himaj, ka njoftuar AK poashtu me shkrim se citat: "Une nuk kam nenshkruar asnje dokument lidhur me projektin ne fjale, si marreveshje bashkepunimi apo parakontrate. Ju njoftoj se une personalisht nuk i pranoj pergjegjesite te cilat mund te rrjedhin nga ajo parakontrate pasi qe une personalisht nuk e kam nenshkruar kete kontrate. Ne fund edhe njehere deklarohem se dokumentet e mia si diploma, CV jane keqperdorur pa dijenin time dhe une aktualisht jam punesuar ne kompanin DT Mining SHPK dhe VB Invest SHPK, dhe aty jam punetor i rregullte mbarium citati, andaj AK dokumentet e dorezuara prej juve ne emer te Gazmend Himaj inxh.i ndertimtarise i ka vleresuar si deshmi mashtruese dhe si te tilla nuk i ka marr ne konsiderate.*

-Mungesa te deshmive te kerkuara si ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit paraqet shmangie ne kerkesat e saktesuara si ne nenin 9.1 lidhur me 9.2 pika 1 te seksionit 2 te Fleta e te dhenave te tenderit, kerkesat mbi mundesite teknike dhe / ose profesionale. Kjo ka ndikuar drejteperdrejte ne pamundesine e plotesimit prej juve te kerkesat e saktesuaara mos deshmimin e aftesise se juaj per ti permbushur kerkesat e kapacitetit teknik dhe ose profesional dhe per rrjedhoj dhe edhe ne garantuara dhe siguaruar AK per perfundimin e sigurt, ne kohe dhe ne menyre cilesore te puneve dhe ose sherbimeve per te cilat keni aplikuar – tenderuar, ne veqanti lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional dhe besueshmerine e kryerjes se puneve te njejta si ne titull te aktivitetit te prokurimit.

Ne pajtim te plote me dispozitat e LPP dhe rregullave te Prokurimit Publik, AK nuk mund te ndryshoj asnje aspekt te nje tenderi, ndersa tenderuesi eshte pergjegjes per te siguruar saktesine e tendereve te tyre, bazuar ne kerkesat e parashtruara ne dokumentin Fleta e Te dhenave te Tenderit ne kete menyre ju si Operator ekonomik nuk keni respektuar keto kerkesa dhe per pasoje keni bere devijim thelbesor nga kerkesat e percaktuara dhe specifikimet e detyrueshme gjegjesisht keni bere devijim qenesor-thelbesor nga kerkesat e tenderit, gje qe e ka bere qe vleresimin per rregullueshmerine e deshmive te dorezuara lidhur me specifikimin e kualifikimeve shkollore dhe profesionale te personelit tuaj udheheqes te mos jete i plot i rregullte dhe i pranueshem. Andaj sipas dispozitave te LPP-se te rregullave te Prokurimit publik ne Kosove tenderi juaj eshte i refuzuar.

<u>Pretendimi nr.1</u>

AK-Komuna Vushtrri ka bere shkeljen e nenit 108/A te LPP-se, pasi qe nuk na e ka shqyrtuar kerkesen tone per rishqyrtim lidhur me projektin ne fjale.

Ne si OE kemi bere kerkese per rishqyrtim prane AK-Komuna Vushtrri, por AK nuk e ka shqyrtuar fare kerkesen tone per rishqyrtim dhe nuk kemi pranuar asnje pergjigje gjer me tani.

Pra, AK ka bere shkelje flagrante duke mos na u pergjigjur fare.

LPP e detyron AK qe pas nje kerkese per rishqyrtim ti trajton pretendimet ankimore, por AK nuk e ka bere nje gje te tille.

AK ka shkelur paragrafin 2 te nenit 108/A - Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar.

Poashtu AK ka shkelur edhe paragrafin 6 te nenit 108/A te LPP-së, sepse nuk e ka trajtuar ankesen sipas afatit ligjor.

***Paragrafi 6 i nenit 108/A te LPP-se** thote (citim):*
Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.

Pra, AK ka bere shkelje flagrante duke mos respektuar afatet ligjore dhe duke mos e respektuar fare LPP-në.

Pretendimi nr.2

Arsyetimi i AK-se nuk qendron fare sepse ne si OE jemi eliminuar njeanshem/padrejtesisht nga AK Komuna Vushtrri me arsyetimin se Inxhinierin e diplomuar te ndertimtarise – konstruktiv z.Gazmend Himaj nuk eshte punetor i kompanise sone.

Deklarimi i inxhinierit se kinse nuk eshte punetor i kompanise sone, nuk qendron fare sepse i njejti ka presion dhe eshte shantazhuar nga kompania fituese, ku kemi deshmi.

Sqarim:

Inxhinieri Gazmend Himaj i cili ka nenshkruar parakontrate, ku eshte paguar (ka pranuar page), i njejti na e ka derguar diplomen e noterizuar dhe i njejti inxhinier Gazment Himaj eshte ne liste te pagave, ku keto do tua deshmojme.

Si eshte e mundur nje inxhinier te kete page, te kete parakontrate te nenshkruar dhe te sjell diplomen e noterizuar dhe te thuhet se nuk jam punetor i kompanise.

Ketu shihet haptas se ka shantazh, ku i kemi mesazhet qe i ka derguar vet inxhinieri ne telefonin e pronarit te kompanise.

Te gjitha do tua deshmojme (keto deshmi ua kemi derguar juve si AK ne sqarimin e meparshem).

Shtrohet pyetja nga kush dolen informatat per inxhinierin dhe emrin e tij?

Deshmite per inxhinierin dyshojme me baze se jane dalur nga Zyra e Prokurimit te Komunes Vushtrri, qe ju si AK ne bashkepunim me kompanine fituese , ku i eshte bere shantazh inxhinierit , ku dyshojme se e kane josh me mjete financiare per te bere kete veprim jo ligjor.

Pasi qe i kemi deshmine qe ka treguar vet inxhinieri permes mesazhit telefonik (do ta bashkangjesim kete fakt).

Pra, *Ne si OE e kemi kontratën, Diplomen e noterizuar te fakultetit nga vet inxhinieri Himaj. Pra, si eshte e mundur te kemi dëshmitë e tij te gjitha te kemi mesazhet te kemi dokumentet, inqizimeet dhe i njëjti te mos jete inxhinieri i kompanise sone, poashtu kemi edhe listen e pagave.*

Si eshte e mundur AK te mos na kërkoj sqarime neve si punëdhënës sepse neni 72 i LPP-se thotë:

AK mund ti kërkoj sqarime operatorit ekonomik, qe ne rastin konkret jemi NE, dhe nuk thotë ti kërkojë sqarime punëtorit te operatorit ekonomik. Sepse ne jemi ofertues e nuk eshte ofertues inxhinieri.

Shihet haptas se ky arsyetim i juaji eshte tendencioz vetem per te na eliminuar.

Kerkojme nga ju si OSHP qe ti analizoni deshmite tona dhe te mos veproni njeanshem vetem per te na eliminuar.

Ne si OE pas marrjes se mesazheve nga inxhinieri me dt.11.10.2020 ju kemi shkruar email si sqarim juve Zyres se Prokurimit, Kryetarit te Komunes z.Xhafer Tahiri se jeni duke vepruar njeanshem duke na eliminuar, por ju vazhduat perseri duke na eliminuar dhe duke e shpallur OE te preferuar BAGERI.

Pretendimi nr.3

Lidhur me arsyetimin e AK-se se ne si OE nuk i kemi referencat per plotesimin e kriterit te kerkuar.

Kërkesa 1. Projekte të përfunduara të punëve të ngjashme (ndërtim, rehabilitim, rikonstruimit të rrugëve) në tre vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, jo më pak se për LOT-1 1,299,064.91€, dhe për LOT-2 1,820,261.43€ Në rast Grupit të Op.Ek. lideri i grupit duhet të ketë kontrata të punës të realizuara gjatë tre viteve të fundit deri më datën e publikimit të Njoftimit për Kontratë jo më pak se 60% të vlerës së saktësuar si më lartë.

Dëshmia 1. Listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata aose referencë për kryerje dhe ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; (i) kur punët janë kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) ose referencë ,të

RCE

7

rëndësishme të lëshuar ose të bashkënënshkruara nga autoriteti I tillë; (ii) kur punët janë kryer për një blerës privat, për dëshmi të këtij shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i punës së tillë;

Ne si OE e plotesojme kriterin e kerkuar pasi qe ne listen tone kemi 3,224,674.05 €, pra jo qe nuk e plotesojme, por e trefishojmë kete kriter.

AK per cdo paqartesi mund te na kerkoj sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-se

Paragrafi 2 i nenit 59 te LPP-se thote: "Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues".

Paragrafi 1 i nenit 72 te LPP-se thote: "Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës".

Pra, AK pa asnje baze ka bere eliminimin tone.

edhe sipas nenit 39 te RRUOPP-se:

AK ka shkelur edhe nenin 39 te RrUOPP-së qe thote:

39. Sqarimi i Tenderëve

39.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, AK mund të kërkoj nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj. KRPP ka aprovuar një formular standard B47 për sqarime për të përdorur nga AK "Kërkesë për sqarim të tenderit". Kërkesa për sqarim dhe përgjigja duhet të bëhet përmes platformes elektronike.

Pra, AK i ka kërkuar sqarime dhe AK nuk i ka sjellur sqarimet e nevojshme lidhur me pajisjet dhe automatikisht AK ka qene dashtë te eliminon OE "ALFA.i" e jo ta shpërblejë per here te dyte me kontrate.

AK duke e demtuar buxhetin publik, ka bere shkeljen e nenit 1 dhe 6 te LPP-se, duke na eliminuar neve si OE i pergjegjeshem dhe duke e shpallur nje OE tjeter te papergjegjshem qe ne pretendimin nr.3 do tua paraqesim deshmite pse eshte OE i papergjegjshem.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me nenin 1 te LPP-se qe thotë se:

Qëllimi i Nenit 1 te LPP-se është: **"Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke**

RAH

8

përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla".

AK ka shkelur edhe **nenin 6 te LPP-se (ekonomiciteti dhe efikasiteti),** ku duke dëmtuar buxhetin dhe duke mos analizuar dhe mos marrur për baze kursimin e buxhetit na ka eliminuar padrejtësisht.

Neni 6 **(Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)** i LPP-se thotë:

Paragrafi 1 i nenit 6 thotë **"Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit"**, dhe

Paragrafi 2 i nenit 6 thotë: **"Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës".**

Pra, AK duke e shkelur nenin 1 dhe 6 te LPP-se e dëmton buxhetin publik duke e përzgjedhur OE edhe pse me çmim me te lirë se oferta jone por nuk ka pajisjet sipas kriterit te kërkuar nga AK-ja dhe eshte i papërgjegjshëm.

Pra, AK nuk e ka marr per baze fare kursimin e buxhetit publik dhe ka bere shkeljen e nenit 7 Barazia ne trajtim /jo diskriminimi.

Pretendimi nr.4

OE i rekomanduar per kontrate OE. "BAGERI" ka cmime jo normalisht te uleta ne oferten e tij, per faktin se ne pozicionet e betonit dhe armatures ka cmime teper te uleta qe asnje prodhues nuk mund ti arsyeton cmimet e tij dhe as vet OE ofertues.

AK nuk ka kerkuar sqarime shtese sipas nenit 61 te LPP-se, per Cmime jo normalisht te uleta.

Ne si OE kemi kerkuar oferta ne dy kompani prodhuese

Ne pozicionin nr.7 Furnizimi dhe punimi i pusetave te reja duke perfshire furnizimin dhe montimin e gypave te pusetes Ø 1000 se bashku me konus Ø 1000/600 si kapaku prej kompoziti me peshe 40 T.

OE i rekomanduar "Bageri", ka ofertuar me cmim 1.00 €, kurse ne kemi marr oferta nga prodhues ku cmimi eshte 100.00 €, pasi qe ne jemi importues te kapakeve kompozit, kurse ne kemi ofertuar me cmim 120.00 €.

Si eshte e mundur ne si importues e kemi cmimin 120.00 €, kurse OE i rekomanduar e ka cmimin 1.00 €.

Ne pozicionin nr.9 Germimi i kanalit per kolektoret kryesor dhe sekondar ne kat.III-IV te dheut me makine ne gjeresi B=60 cm, ku OE i rekomanduar ka cmim 0.10 €, kurse cmimi real

per pune te tilla eshte min.1.00 € (m3)

AK duhet ti kerkoj sqarime sipas nenit 61 te LPP-se sepse keto jane cmime jo-normalisht te uleta dhe keto cmime nuk jane aspak serioze, vetem nese qellimi i AK-se eshte per te mos i vendosur fare dhe per tia ndihmuar marrjen e ofertes OE se rekomanduar (OE.Bageri). Ndoshta eshte ky qellim, qe edhe nese nuk ekzekutohen ne jemi perseri me te lire se OE i rekomanduar (Bageri).

Ne pozicionin nr.19 Furnizimi dhe betonimi i elementeve konstruktive me beton te armuar C25-30 Mpa, pahite perkatese sipas projektit, ku OE i rekomanduar ka cmim 1.00 €, kurse çmimi i tregut eshte 40-45 € = 1 m3.

Pra, si eshte e munduar me 1.00 € te vendoset cmimi per 1 m3 beton C25-30 .

Keto shihet haptas se jane cmime jo-normalisht te uleta.

AK duhet te kerkoj sqarime sipas nenit 61 te LPP-se tek prodhuesit e betonit.

Ne pozicionin nr.10 Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave te brinjezuar PE SN 8 per kolektoret e kanalizimit fekal PESN8 Ø 315 mm, ku OE i rekomanduar ka vendosur cmim 0.20 € per 1 meter gjatesi, kurse cmimi nga prodhuesit eshte 6.00 – 6.50 €, ku ne kemi ofertuar me cmim 7.00 €.

Ne pozicionin nr.20 Blerja, transporti, prerja dhe vendosja e armatures ÇBR-400/500 Mpa ne teresi ne te gjitha pozicionet sipas llogarise statike, ku OE i rekomanduar ka ofertuar 0.01 €/kg, ku vetem blerja kushton 1 kg = 0.40 €.

Pra, si eshte e mundur OE. "Bageri" te oferton me 0.01 €, ku as ne prodhim nuk eshte me lire se 0.33 €/kg.

Ketu shihet haptas se ka cmime jo-normalisht te uleta, dhe AK nuk ka vepruar fare sipas nenit 61 te LPP-se per ti vertetuar keto cmime, ndoshta se ka pasur interes per ta shperblyer me kontrate OE "Bageri".

Pra, AK duhet ti kerkoj sqarime shtese per pozicionet jo-normalisht te uleta dhe te vertetohet edhe nga prodhuesit edhe nga tregtia keto cmime.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 61 te LPP-së (Tenderi me çmim jo normalisht te ulet)

Paragrafi 2 i nenit 61 te LPP-së thote (citim): *Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:*

1.1. ekonominë e procesit të prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
1.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;
1.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin

MERCE

e aktiviteteve të ndërtimit që jamë duke u prokuruar; dhe/ose
1.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 69 te LPP-se (Afësitë Teknike dhe/ose profesionale)

Pra, AK ka bere shkeljen e nenit 1, nenit 6, nenit 7, nenit 59, nenit 69 te LPP-së

Te bashkangjitur i gjeni nenet e LPP-së që i ka shkeluar AK duhe e shpërblyer me kontratë OE. "Bageri" LOT 2 dhe "KOSOVA ASFALT"-LOT 1 .

Pretendimi nr.5

AK ka shkelur nenin 7 Barazia ne trajtim-jo diskriminimi pasi qe na ka diskriminuar neve vetem per ta favorizuar kompanine e rekomanduar per kontrate, ku kjo shkelje ligjore eshte verejtur edhe ne kriteret e shpalljes, sepse kriteret diskriminuese kane qene edhe ne njoftim per kontrate dhe ne FDT, ku pajisja eskavator 65 Ton, ka qene pajisje jo e nevojshme per shtrim te rrugicave, sepse puniment mund te kryhen edhe me eskavator 20 T, pra edhe nga ky kriter shihet se i preferuari juaj ka qene OE Bageri.

AK ka shkelur edhe 7 (Barazia ne trajtim/jo-diskriminimi) te LPP-se qe duke mos i vlerësuar ofertat njejte na ka eliminar padrejtësisht duke na diskriminuar neve edhe pse i kemi plotësuar kërkesat e kërkuara nga AK . ku kete e sqaron paragrafi 1 dhe 2 i nenit 7 te LPP-se.

Neni 7 i LPP-se thotë:

Paragrafi 1 i nenit 7 thotë: Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Paragrafi 2 i nenit 7 thotë: Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Pra, ky kriter ka qene qe te favorizohet OE i rekomanduar i juaji.

Pretendimi nr.6

Lidhur me kerkesen e FDT dhe NJK, **Kërkesa 6. Operatori Ekonomik duhet te këtë Gurëthyes te licencuar ne pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavorr.**

Dëshmia 6. Duhet të dëshmohet kopja e Licencës leje per aktivitete te veçanta , valide dhe e vlefshme e lëshuar nga Agjencia për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licenca e OE. Marreveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësit dhe qiradhënësit.

Pra, OE i rekomanduar nuk e ka te noterizuar marreveshjen per Furnizim me zhavor ne emer te qiramarresit dhe qiradhenesit, kurse OE i rekomanduar nuk e ploteson kete kriter.

RAHO

11

Pra, nuk eshte marreveshja e noterizuar sipas kerkeses se AK-se, por ka vetem vertetim nenshkrimi i dt.11.03.2020, ku thote se Noteri ne kuptim te nenit 46 verteton dokumentin kopje nga origjinali, gje qe e verteton se nuk eshte marreveshja e noterizuar per projektin, por eshte vetem vertetim nenshkrimi, qe nuk e permbush kriterin e AK-se si ne FDT dhe NJK. Pra, AK ka shkelur nenin 59.4 te LPP-se, qe thote:

Paragrafi 4 i nenit 59 te LPP-se thotë: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"..

Te bashkangjitur ne kete kerkese per rishqyrtim gjeni:

1. Deshmite per inxhinierin Gazmend Himaj, kontraten dhe listen e pagave qe deshmon se eshte punetor i kompanise sone.

2. Mesazhet e derguara nga Inxhinieri Himaj se ka presion (qe me kete e deshmon se i eshte bere shantazh);

3. Cmimet e OE. "Bageri" si cmime jo-normalisht te uleta, sipas pozicioneve,

4.Marreveshja e bazes se asfaltit, dhe zhavorrit.

Përmes kësaj kërkese për rishqyrtim, kërkojmë nga AK qe ta kthej lenden ne rivlerësim te anulon OE e papërgjegjshëm siç është OE."BAGERI" dhe te na shpërblen neve me kontrate "Rahovica Comerce" Ferizaj si një kompani me eksperience.

Kërkojmë nga OSHP-ja qe te merr :

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e **OE "Rahovica Comerce"SHPK Ferizaj**

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së,

DETYROHET, autoriteti kontraktues që të bëjë rivlerësimin e ofertave dhe te na shpalle fitues neve me çmimin me te ulet me dokumentacion te përgjegjshëm e jo te veproj siç ka vepruar deri tash duke na eliminuar padrejtësisht dhe duke e shpallur OE e pakompletuar (papërgjegjshëm) vetëm e vetëm per ta shpërblyer me kontrate operatorin e preferuar!.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Ne si kompani jemi dëmtuar me shume se 2,500 Euro për shpenzimet e gjertanishme dhe na është dëmtuar imazhi i kompanisë sonë pasi qe produktet tona janë origjinale dhe janë te prodhuara nga prodhuesit botëror.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

ERCE